



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT
O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Më datë **30.09.2014**, Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN) realizoi **vizitë të rregullt të paparalajmëruar** në SP Krushevë (e cila është vizita e parë e realizuar nga ekipi i MPN-së në këtë stacion policor).

Qëllimi i vizitës, në përputhje me Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese, është identifikimi i rreziqeve me qëllim të parandalimit të torturës dhe llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Vizita në këtë stacion policor u zbatua në atë mënyrë që fillimisht u zhvillua bisedë me kryeshefin e stacionit policor dhe më pas vizita vazhdoi me kontrollin e pjesës së hapësirave zyrtare dhe ndihmëse të SP Krushevë.

Pas kontrollit, ekipi i MPN zbatoi këqyrje në disa regjistra dhe evidenca:

- Librin për ngjarjet e ditës;
- Evidencën për personat e arrestuar;
- Regjistrin për përdorimin e mjeteve të dhunshme;
- Evidencën për personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar, dhe
- Regjistrin për parashtrësuar nga qytetarë kundër nëpunësit zyrtar, si dhe në
- Një numër të caktuar të dosarëve individual për personat e ndaluar.

Në përputhje me Aktvendimin¹ për përcaktimin e stacioneve policore për ndalimin e personave, ky SP është përcaktuar si stacion për ndalim, megjithatë realisht i njëjti nuk ka kushte hapësinore konform standardeve vendase dhe ndërkombëtare për ndalimin e personave të privuar nga liria. Përkatësisht, personat e privuar nga liria ndalohen në zyrat e zyrtarëve të nëpunësve policorë. Zyrat e zyrtarëve nuk kanë në dispozicion mjete përkatëse për pushim (krevat, dyshek, shtroje) dhe nuk i plotësojnë kushtet për ndalime më të gjata në orët e natës. Njëkohësisht, Mekanizmi Parandalues Nacional shprehu shqetësim në kontekst të asaj se personat e privuar nga liria vendosen në hapësirë e cila shfrytëzohet edhe për dedikime të tjera dhe në këtë mënyrë të njëjtët mund të vihen në pozitë përçmuese.

¹ Aktvendimi për përcaktimin e stacioneve policore për ndalimin e personave, nr. 12.1-82035/1 i datës 18.11.2011, i miratuar nga ana e MPN-së ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 163/11), përcakton 38 stacione policore në të cilët ndalohen persona.

Stacioni policor nuk disponon as me hapësirë të veçantë për vizitë/kontroll, ndërkaq kontrolli mjekësor i personave të privuar nga liria bëhet në korridorin e stacionit policor, ndërsa biseda me personat e privuar nga liria zhvillohet në zyrat e zyrtarëve.

Në momentin e vizitës nuk kishte persona të ndaluar, me të cilët ekipi i MPN-së do të mund të bisedonte rreth trajtimit të tyre nga ana e nëpunësve policorë dhe rreth kushteve të ndalimit në këtë stacion policor.

Sipas informatave të pranuar nga kryeshefi i SP Krushevë, në këtë stacion policor janë të punësuar dy udhëheqës të turnit. Në pjesën e trajtimit të fëmijëve u informuam se ky SP nuk disponon me hapësirë të veçantë për ndalimin e fëmijëve dhe së këtejmi bëhen përpjekje që të mos ndalohen, e as nuk ka inspektor i cili do të punojë ekskluzivisht me persona të mitur. Gjatë ndalimit të personit të mitur çdoherë njoftohet qendra për punë sociale, si dhe avokati, në përputhje me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve, por ndodh që Qendra të mos vijë me rregull në rastet e ndalimit të personit të mitur.

Duke u udhëhequr sipas standardeve ndërkombëtare për personat e privuar nga liria, atyre u garantohet e drejta e ushqimit, ndërsa Procedurat Standarde Operative të MPB-së përcaktojnë minimum një vakt gjatë periudhës së ndalimit (nëse ndalohet më shumë se 6 orë). Nga biseda e zhvilluar me kryeshefin, u tha se ky stacion policor nuk disponon me buxhet të veçantë për sigurimin e ushqimit për personat e ndaluar, ndërsa ushqimi sigurohet nga ana e nëpunësve policorë në rastet kur personi i ndaluar nuk ka mjete në para të veta.

Regjistri për ngjarjet e ditës udhëhiqet me rregull, në të janë plotësuar të gjitha kolonat, për çdo ngjarje ka përshkrim të detajuar, i cili është i qartë dhe i lexueshëm. Në regjistrin për ngjarjet e ditës gabimet fshihen me vizë, përkatësisht nuk përdoret korrektori.

Kontrolli i dosarëve individual për personat e ndaluar u bë sipas përzgjedhjes së rastit (në një lëndë, në të cilën u bë këqyrje, bëhej fjalë për person të mitur). Ekipi i MPN-së gjatë kontrollit konstatoi se dosarët nuk udhëhiqen me rregull, përkatësisht formati për dosar individual nuk përdoret për të gjitha lëndët, dokumentacioni në një pjesë të dosarëve nuk ishte i plotë dhe nuk ishte plotësuar tërësisht, ndërkaq në një lëndë mungonte procesverbali për personin e ndaluar.

Për vizitën, Mekanizmi Parandalues Nacional përgatiti raport të veçantë në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia drejtoi Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe vet stacionit policor, me qëllim të eliminimit të mangësive të konstatuara.